


# *buletini*info

Buletin informativ mujor  
Mars, 2022



## Memorandum bashkëpunimi për bursa nga radhët e komuniteteve



Shënohet 21 vjetori i  
themelimit të IRDK-së



Çfarë është Y-ADN?



Aftësimi i nxënësve  
për mësim të pavarur

## KËNDVËSHTRIM I NGJARJEVE TË KËTIJ MUAJI NGA POLITIKA JONË

**N**jë vit nga formimi e Qeverisë së Kosovës. Diçka që do të mbetet e shënuar është fakti se në Qeverinë e cila e filloi mandatin në mars të vitit 2021, një ministri e drejton një pjesëtar i komunitetit Egjiptian. Pra Elbert Krasniqi, pjesëtar i komunitetit Egjiptian dhe kryetar i partisë së parë të Egjiptianëve, është ministri i parë nga komuniteti Egjiptian që tani drejton Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal. Drejtimi i Ministrisë nga ministri Elbert Krasniqi nuk erdhi si rezultat i ndonjë pazari politik me partinë tani në pushtet, por erdhi për shkak të vlerësimit të drejt të mbajtjes së parimeve në periudhën kur shumica që fitoi në zgjedhjet e vitit 2019 u hodh në opozitë nga blloku që pranoi të notoj nëpër aventura të pa zakonshme për demokracinë.

Sikur para një viti kur Elbert Krasniqi u emërua Ministër në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, edhe tani ndaj mendimin se Ministri duhet të ndihmohet nga të gjithë ne, që ai të drejtoj ministrinë me sukses dhe të jetë edhe në dobi të komunitetit Egjiptian i cili ka nevoja të shumta. Ajo çfarë më bënë të lumtur është se ministri po ia del me sukses të drejtoj këtë dikaster të Qeverisë dhe për këtë kanë treguar edhe vlerësimet e pavarura të cilën e vendosen në krye të listës sa i përket realizimit të planit të punës.

Krahas projekteve të infrastrukturës, nëpër komuna të ndryshme, që u realizuan vitin e kaluar, në këtë muaj u nënshkrua Memorandumi i bashkëpunimit të ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit dhe Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal. Për nënshkrimin e këtij Memorandumi është angazhuar shumë ministri Elbert Krasniqi. Kjo nismë synon subvencionimin e studentëve me bursa në mënyrë që në të ardhmen të kemi mësimdhënës nga radhët e komunitetit Egjiptian të cilët do të jenë pjesë e mësimdhënies në sistemin e arsimit të Kosovës. Rritja e numrit të mësimdhënësve ka për synim një përkujdesje të shtuar për nxënësit tanë nëpër

shkolla që do të trajtohen e vlerësohen drejt dhe për arritjen e një situatë që komuniteti Egjiptian të mos jetë vetëm konsumues i shërbimit të mësimdhënies por të jetë edhe ofrues i suksesshëm i këtij shërbimi. Është e njohur botërisht se arsimimi është arma më e fuqishme e luftimit të paragjytimeve. Një i arsimuar është në gjendje që të shtroj pyetje se pse paragjykohet. Duke mos e trajtuar paragjykimin si të zakonshëm, i arsimuari vendoset në frontin e mos nënshtrimit dhe kundërshtimit të kësaj dukurie. Prandaj nisma për rritjen e mësimdhënësve nga radhët e komunitetit Egjiptian bashkë me nismën që unë pres që të shtyhet përpara e që ka të bëjë me luftimin e braktisjes së shkollave përmes subvencionimit të familjeve të varfëra, janë shtylla strategjike për përparimin e komunitetit.

Deputeti i Parlamentit të Kosovës nga radhët e IRDK-së, Fridon Lala, gjatë këtij muaji pati një prezantim dinjitoz në Parlamentin Nacional Francez, i cili pa asnjë kompleks paraqiti qëndrimin e Republikës së Kosovës lidhur me agresionin e Rusisë në Ukrainë dhe pakënaqësinë për mos liberalizimin e vizave për qytetarët e Republikës së Kosovës.

Me 12 Mars u mbushën 21 vite kur është themeluar partia e parë politike e komunitetit Egjiptian. IRDK arriti të qëndroj në shërbim të komunitetit për 21 vite. Në periudhën në mes viteve 2014 – 2019, IRDK nëpër rrjeta sociale ishte shpallur e vdekur nga drejtues të një formacioni të pa pjekur politik. Sigurisht se ky ishte vlerësimi më i dobët i tyre pasi që realiteti tregon se ujërat e politikës dinë që të ngritin por dinë edhe të përmbysin. Ne që jemi më gjatë në politikë, provimin e ngritjes dhe rënies politike e kemi kaluar, prandaj nuk i servojmë askujt moto mendje-madhe, sikur mund të jetë motoja "Ecim tutje", por në çdo kohë mirëpresim bashkëpunimin dhe unitetin. Jemi pak dhe të vegjël, prandaj uniteti i komunitetit është më i çmuar tani dhe kurdoherë.

**Fazli Stollaj**





## PËRKUJTOHET IMER ALIJAJ

Me 4 Mars të këtij viti janë bërë tetë vite që është ndarë nga jeta Imer Alijaj. Kryetari i IRDK-së, Elbert Krasniqi, me bashkëpunëtor dhe familjar kanë bërë homazhe te varri ku pushon tash e tetë vite Imer Alijaj. Tetë vite janë të gjata por neve na duket se dje është ndarë nga ne Imeri, theksoi kryetari Elbert Krasniqi. Ai shtoi se vetë fakti që ky vend ka qenë i vogël për njerëzit që i dhanë lamtumirën e fundit tregon se Imeri ishte njeri i dashur për të gjithë.

Imer Alijaj kishte studiuar në Universitetin e Prishtinës dhe kishte diplomuar duke fituar gradën e inxhinierit të makinerisë. Ai e dha kontribut të veçantë në LDK gjatë viteve të '90 duke qenë aktiv në strukturat e ndërtuara të asaj kohe. Në vitin 1999 me guximin e tij doli në mbrojtje të të drejtave lirive të popullit të tij duke qenë themelues i Shoqatës "Shqiptaro-Egjiptiane". Imeri me vizionin e tij ndërtoi koncepte të qarta programore në IRDK duke e trasuar rrugën e Egjiptianëve të Kosovës në integrim në institucione të Kosovës, në promovimin e identitetit kombëtar dhe në avancimin e pozitës së tyre në shoqërinë e Kosovës.

Imer Alija vdiq në moshën 55 vjeçare, me 4 Mars të vitit 2014. I përhershëm mbetet kujtimi për Imer Alijaj një ndër themeluesit e IRDK-së dhe intelektual e vizionar i rrallë në mesin e komunitetit tonë.



## **APEL INTELEKTUALEVE**

Pasivitet do të thotë t'ia kthesh shpinën problemeve, e kjo është dukuri e dëmshme si për individin, ashtu edhe për shoqërinë njerëzore.

Në mjerimin tonë të tanishëm nuk kemi të drejtë të lavdërohem me famën e dikurshme, por ne duhet të kuptojmë se neglizhenca, pasiviteti dhe përtacia janë e ka shkaktuar dekadencën tonë të tanishme e jo ndonjë e metë tjetër. Ne intelektualët nuk duhet të jemi pengesë e progresit, punës etj. Aktiviteti i intelektualëve edhe nga feja Islame çmohet gjerë në atë shkallë sa që ato(aktivitetet) i vë mbi Engjuj. Përtacia dhe pasiviteti janë pengesë e progresit njerëzor të një shoqërie prandaj ekziston një motiv që të flitet për bashkimin dhe unitetin e popullit tone sidomos I intelektualëve tonë.

Populli jonë po kalon nëpër një fazë të dëshpërimit dhe të nervozes, humbjes së identitetit të vetë, humbjeve materiale, sociale, ekonomike etj. Përparimi dhe zhvillimi jonë kërkon vendosjen e bashkimit e të gjithëve pa përjashtim sepse bashkimi është mishërim e personifikim e gjithëçkëqit që është e mirë dhe fisnike. Bashkimi është kriter civilizues i përparimit të popullit sepse e forcon fisnikërinë, dinjitetin dhe sovranitetin e tyre. Përveç kësaj, bashkimi është bërë nevojë ekonomike, politike, sociale dhe kulturore. Pos kësaj rrjedha e historisë botërore nxit ekzistimin e asociacioneve të mëdha siç janë OKB, OSCE, UNHCR etj. që të merret me këtë popull.

Suksesi në këtë punë kërkon udhëheqje, urtësi, dituri qëllim të mirë dhe siguri të rrethanave të volitshme të brendshme dhe të jashtme, që realisht mund të zgjasë gjatë. Qëllimi im është vendosja e themeleve të mënyrës së jetesës nacionale. Duhet të kemi një vizion të plotë civilizues për të tashmen dhe të ardhmen tonë që do ta bëjmë së bashku. Mungesa e këtij vizioni nga sfera e politikës, shoqërisë, mendimit dhe kulturës e paralizojnë çdo aktivitet dhe përpjekje që ka të bëjë me çështjen tonë. Andaj ekzistimi i vizionit i cili e analizon të tashmen dhe e ndërton të ardhmen paraqet domosdoshmëri për ta kuptuar aktualitetin dhe zbulimin e asaj që sjell ardhmëria. Para neve qëndron një punë e madhe, përndryshe do të mbesim në marginë të ngjarjeve duke i imituar dhe duke u mbështetur të tjerët.

Mars, 2010  
**Imer Alijaj**





## SHËNOHET 21 VJETORI I THEMELIMIT TË IRDK-SË

Në 21 vjetorin e themelimit të IRDK-së, në Gjakovë, në prani të aktivisteve të IRDK-së është shënuar kjo ditë e veçantë për IRDK-në dhe për komunitetin Egjiptian.

Kryetari i IRDK-së, Elbert Krasniqi, theksoi se 21 vite të ekzistimit të IRDK-së janë të gjata për veprimtari politike të cilat pa dyshim se kanë lënë gjurmë në historinë e komunitetit Egjiptian. Ai ka kujtuar themeluesit e IRDK-së, Beslim Hotin, Avdulla Qafanin, Hasa Kerrshi, Kapllan Kerrshi, Ibish Bajramin, Imer Alijaj, Gazmend Dervishi, Ramë Berisha e shumë veprimtar tjerë të cilët patën guximin që në kohë shumë të vështira të marrin përgjegjësi për komunitetin.

Edhe deputeti Fridon Lala ka kujtuar veprimtarët e parë politik të cilët kanë lënë trashëgimi politike të gjeneratat e reja të cilët e kanë rrugën e trasuar për veprimtari politike në dobi të komunitetit.

Në këtë manifestim kanë folur edhe themeluesit e IRDK-së, Xhevdet Neziraj, Ramë Berisha dhe Fazli Stollaj.

Në këtë datë të rëndësishme për IRDK-në ka filluar funksionimi i zyrës së degës së IRDK-së në Gjakovë.









## MEMORANDUM BASHKËPUNIMI PËR BURSA NGA RADHËT E KOMUNITETEVE ASHKALI, EGJIPTIAN DHE ROM

Me 17 Mars të këtij viti është nënshkruar Memorandumi i Bashkëpunimit në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, e përfaqësuar nga ministria znj. Arbërie Nagavci dhe Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal e përfaqësuar nga ministri z. Elbert Krasniqi. Me Ministren e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, znj. Arbërie Nagavci kam nënshkruar memorandumun e bashkëpunimit për ofrimin e bursave për studentët nga radhët e komuniteteve Ashkali, Egjiptian, dhe Rom", ka deklaruar ministri Elbert Krasniqi pas nënshkrimit të memorandumit. "Përmes kësaj mbështetje financiare do të krijohen kushte që studentët nga komunitetet të mos i ndërpresin studimet për shkak të kushteve të vështira materiale si dhe të krijohen breza të rinjë të mësimdhënësve dhe ligjëruesve nga radhët e komuniteteve" – ka vazhduar ministri Krasniqi.

Ministrja e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, znj. Arbërie Nagavci në këtë rast, theksoi rëndësinë e mbështetjes financiare për studentët e këtyre komuniteteve, përmendi edhe mbështetjen që po jep Ministria për Qendrat mësimore me bazë në shkollë dhe me bazë në komunitet, si dhe bursat që ndahen për nxënësit e shkollave të mesme për komunitetet ashkali, egjiptian dhe rom.



Qëllimi i këtij Memorandumi të Bashkëpunimit është promovimi i edukimit tek komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian dhe nxitja në zhvillim akademik, përmes ofrimit të ndihmës financiare për studentë në të gjitha universitetet publike të Republikës së Kosovës.

Kjo mbështetje ka për qëllim ofrimin e ndihmës financiare për studentët nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian, në mënyrë që t'i ndjekin dhe përfundojnë studimet në universitetet publike. Një gjë e tillë do krijonte kushte që studentët nga këto komunitete, të mos i ndërprejnë studimet për shkak të kushteve të vështira materiale. Gjithashtu do të sjellte përfitime afatgjata për gjithë shoqërinë pasi do të kontribuonte në krijimin e kuadrit me kualifikim të lartë nga këto komunitete të cilët për momentin janë të pakët në numër. Kjo do të ndikoj gjithashtu në rritjen e nivelit arsimor në komunitete përkatëse.

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit do të koordinoj aktivitetet për implementimin e memorandumit. Kjo Ministri do të krijoj dhe kryeson grupin e përbashkët koordinues me përfaqësues nga MASHTI, MAPL dhe Shoqëria Civile. Gjithashtu MASHTI do të siguron mjetet për bursa në baza vjetore dhe do të zhvillojë procedurat e konkursit dhe përzgjedhjes së përfituesve të bursave. MASHTI do të siguron infrastrukturën teknike për procesin e aplikimit për mbështetje financiare dhe do të siguron që të procedohen pagesat e mbështetjes financiare në llogaritë e studentëve përfitues të mbështetjes financiare.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal do të siguron promovimin e thirrjes për mbështetjen financiare në të gjitha Komunitetet e Republikës së Kosovës. Kjo Ministri gjithashtu do të siguron informacion për përshtatshmërinë e kandidatëve të paraqitur në konkursin për bursa dhe do të organizon ceremoninë e ndarjes së mbështetjes financiare për studentët.

MASHTI dhe MAPL do të hartojnë Planin Dinamik për implementimin e Memorandumi të Bashkëpunimit dhe do të bëjnë promovimin e edukimit në arsimin e lartë tek komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian.



## AFTËSIMI I NXËNËSVE PËR MËSIM TË PAVARUR



**Musli Ferizaj**

**D**etyra e mësimit, si proces koherent edukativ- arsimor në të cilin marrin pjesë direkte mësime dhe nxënësit, nuk është vetëm të mësojë nxënësit, por detyrë parësore e tij është të aftësojë ata për mësim (vetëmësim). Rëndësia e aftësimin të nxënësve për mësim të pavarur vjen nga fakti se nxënësit janë shumë të ngarkuar me mësim, nga të arriturat në shkencë, teknikë, leterësi etj.

Në praktikën shkollare mësime dhe nxënës zakonisht kërkojnë prej nxënësve që të riprodhojnë përmbajtjen mësimore. Kërkojnë dituri, por fare pak i mësojnë për të nxënë, përkatësisht nuk i aftësojnë për mësim të pavarur, kështu zakonisht në orët mësimore mësime dhe nxënës ligjëron, kurse nxënës dëgjojnë, shumica e tyre mbesin pasiv.

Mësimi i pavarur mund të aplikohet atëherë ku nxënësit të kenë përvetësuar disa elemente të duhura për aktivitete të këtillë.

Me këtë aktivitet duhet filluar qysh nga klasat e ulëta të fillorës.

Mësimdhënësi ka rol udhëheqës në mësim, por kjo nuk do të thotë se duhet vetëm të ligjërojë, t'u servojë nxënësve njohuri të gatshme.

Ai duhet të gjej mjete, metoda dhe forma pune të përshtatshme me qëllim të aftësimin të nxënësve për mësim të pavarur. Këtij qëllimi i kontribuojnë: detyrat shtëpiake, hartimet me shkrim, detyrat kontrolluese, referatet etj.

Po ashtu mund të thuhet se tekstet e reja mësimore në baza unike (sidomos ato të klasëve të ulëta ) ofrojnë mundësi të konsiderueshme për realizimin e këtij qëllimi.

Po ashtu nxënësit duhet njohur metodat, teknikat dhe procedurat e të mësuarit.

Duhet informuar edhe me mënyrën e përdorimit të teksteve dhe përpilimit të planit gjatë leximit.

Gjurimet psikologjike vërtetojnë se leximi kërkon aktivitet me të lartë se sa të dëgjuarit e ligjëratës. Por nëse gjatë leximit nënvizojmë fjalë të rëndësishme aktiviteti do të jetë edhe më i lartë.

Nëse gjatë leximit formohet plani (koncepti) aktiviteti do të jetë edhe më i lartë. Po kështu shkalla e aktivitetit do të ngritet edhe më tej nëse riprodhohet përmbajtja e lëndës.

Lokali ku mëson nxënësi duhet të jetë i përshtatshëm. Nxënësi duhet të ketë këndin dhe tavolinën e vet të punës. Nëse respektohet ky orar, nxënësi do të formojë shprehje pune. Gjatë leximit ai duhet të ulet në karrikë, të mbajë trupin drejtë në mënyrë që të mos paraqiten deformime trupore, por nga ana tjetër gjatë të mësuarit është e nevojshme një shtrengesë e muskujve.

Kur flitet për të mësuarit e sukseshëm theksohen këto metoda:

**parciale, globale dhe kombinuar.**

Këto metoda kanë përparësitë dhe të metat e veta. Përdorimi i tyre varet nga individit dhe mosha e tij.

**Metoda parciale** - Aplikohet ku lënda mësohet pjesë-pjesë. Kjo metodë është më e lehtë për nxënësin nga se ai më lehtë mëson një pjesë të lëndës se sa një tërësi (temë).

Në këtë mënyrë ai fiton besimin në forcat e veta. Por e metë e kësaj metode është se vështirë bëhet lidhja e pjesëve në tërësi logjike.

**Metoda globale** - Kjo formë mësimi shprehet atëherë kur mësohet lënda në tërësi.

Kështu formohet më lehtë lidhja logjike e pjesëve. Por më qenë se kërkon aktivitet më të gjatë, shkakton lodhje.

**Metoda e kombinuar** - Shprehet atëherë ku kombinohen dy metoda, e para, pra kur lexohet teksti në tërësi dhe pastaj pjesë-pjesë ose e kundërta, së pari në pjesë e pastaj në tërësi. Se cila prej metodave të veçanta do të përdoret e para, varet nga lënda dhe individit që mëson.

Kur është fjala për të mësuarit e sukseshëm


pa përsëritje të asaj që është mësuar, prandaj më të drejtë thuhet se përsëritja është nëna e mësimit.

Pra, kohë pas kohe, sipas nevojës dhe natyrës së lëndës, behet përsëritja e lëndës së mësuar. Të mësuarit është aktiv kur përmbajtja e mësuar e themi me fjalë tona, ky mësim është i suksesshëm se sa leximi pasiv i teksteve. Përsëritja e mësimit me fjalë tona bëhet me heshtje ose me zë. Është mirë të bëhet shprehi përsëritja në heshtje, por kjo varet nga individit.

Këto, pra ishin disa udhëzime për mësim të pavarur. Mësimdhënësit në bazë të literaturës pedagogjiko-psikologjike dhe të përvojës së tyre duhet gradualisht t'i këshillojnë dhe t'i aftësojnë nxënësit për mësim të pavarur.

*Autori i shkrimit është nga Klina, me profesion pedagog, i cili ka punuar në shkollën fillore si mësimdhënësi me shumë gjenerata.*





## Çfarë është Y-ADN?

Y-ADN i referohet ADN-së që gjendet në një nga kromozomet seksuale, kromozomi Y. Ekziston edhe kromozomi tjetër i gjinisë i njohur si kromozomi X. Megjithatë nuk ka asnjë provë që burrat janë në të vërtetë nga Marsi dhe gratë nga Venera, megjithatë këta zakonisht ndryshojnë në një mënyrë të madhe: shumica e meshkujve biologjikë kanë një Kromozom Y që u mungon femrave.

Kromozomet seksuale zakonisht vijnë në çift dhe ndihmojnë në përcaktimin nëse jeni mashkull biologjik apo femër biologjike. Në përgjithësi, meshkujt zakonisht kanë një kromozom Y dhe një X, ndërsa shumica e femrave biologjike kanë dy kromozome X.

Cilat janë haplogrupet Y-ADN?

Një haplogrup është në të vërtetë vetëm një pjesë e ADN-së që gjendet zakonisht në popullata të caktuara. Një haplogrup Y-ADN, pra, është një shtrirje e kromozomit Y që ju ndani me të afërmit meshkuj përgjatë linjës suaj atërore. Pra, nëse keni një Y, e keni marrë nga babai juaj, kush e mori nga babai i tij e kështu me radhë.

Rezulton se për shkak se kromozomi Y, ndryshe nga kromozomet e tjerë të njeriut, nuk ka një partner pothuajse identik, Y-ADN mund të gjurmohet shumë larg në të kaluarën. Në fakt, çdo mashkull i gjallë mund të gjurmohet Y-ADN-në e tij tek një burrë i vetëm, Y-Adam.

Haplogrupet Y-ADN zakonisht përcaktohen duke parë polimorfizmat e vetme nukleotide (SNP). Një SNP (shqiptohet "snip") është një variacion i një blloku ndërtimi të ADN-së, ose nukleotidi, në një pozicion të vetëm në sekuencën e ADN-së. Për shembull, në një pozicion të vetëm në kromozomin Y, shumica e njerëzve kanë nukleotidin timinë (T), por disa njerëz kanë një adeninë (A).

Haplogrupet mund të përcaktohen gjithashtu duke parë përsëritjet e shkurtra të tërthorta (STR). Një STR është një sekuencë e shkurtër e ADN-së që përsëritet, siç është përsëritja GAT (GATGATGAT). Të dy SNP-të dhe STR-të ndihmojnë në grupimin e njerëzve që kanë të njëjtat dallime.

## **Çfarë është testimi gjenetik i prejardhjes?**

Testimi i prejardhjes gjenetike, ose gjenealogjia gjenetike, është një mënyrë që njerëzit e interesuar për historinë familjare (gjenealogjinë) të shkojnë përtej asaj që mund të mësojnë nga të afërmit ose nga dokumentacioni historik. Ekzaminimi i variacioneve të ADN-së mund të japë të dhëna se nga mund të kenë ardhur paraardhësit e një personi dhe për marrëdhëniet midis familjeve. Disa modele të variacionit gjenetik shpesh ndahen mes njerëzve me prejardhje të veçantë. Sa më të lidhura ngushtë të jenë dy individë, familje ose popullata, aq më shumë modele variacioni ndajnë zakonisht.

## **Si funksionon testimi i Y-ADN-së?**

Kur bëni një test të ADN-së të linjës Y, rezultatet tuaja do të tregojnë një haplogrup të përgjithshëm dhe një varg numrash. Këta numra përfaqësojnë përsëritjet (belbëzimet) e gjetura për secilin prej shënuesve të testuar në kromozomin Y. Grupi specifik i rezultateve nga shënuesit e testuar STR përcakton haplotipin tuaj Y-ADN, një kod gjenetik unik për linjën tuaj stërgjyshore. Haplotipi juaj do të jetë i njëjtë ose jashtëzakonisht i ngjashëm me të gjithë meshkujt që kanë ardhur para jush në linjën tuaj atërore - babai, gjyshi, stërgjyshi juaj, etj.

Rezultatet e Y-ADN-së nuk kanë asnjë kuptim të vërtetë kur analizohen më vetveten. Vlera vjen në krahasimin e rezultateve tuaja specifike, ose haplotipit, me individë të tjerë me të cilët mendoni se jeni të lidhur për të parë se sa nga shënuesit tuaj përputhen. Numrat që përputhen më së shumti ose të gjithë shënuesit e testuar mund të tregojnë një paraardhës të përbashkët. Në varësi të numrit të përputhjeve të sakta dhe numrit të shënuesve të testuar, ju gjithashtu mund të përcaktoni afërsisht se sa kohët e fundit kishte gjasa të kishte jetuar ky paraardhës i përbashkët (brenda 5 brezave, 16 brezave, etj.).

Tre lloje të testimit të prejardhjes gjenetike përdoren zakonisht për gjenealogji:

### **Testimi i kromozomit Y**

Ndryshimet në kromozomin Y, të kaluara ekskluzivisht nga babai te djali, mund të përdoren për të eksploruar prejardhjen në linjën e drejtpërdrejtë mashkullore. Testimi i kromozomit Y mund të bëhet vetëm te meshkujt, sepse femrat nuk kanë një kromozom Y. Megjithatë, gratë e interesuara për këtë lloj testimi gjenetik ndonjëherë rekrutojnë një të afërm mashkull për të bërë testin. Për shkak se kromozomi Y transmetohet në të njëjtin model si emrat e familjeve në shumë kultura, testimi i kromozomit Y përdoret shpesh për të hetuar pyetje të tilla si nëse dy familje me të njëjtin mbiemër janë të lidhur.

### **Testimi i ADN-së mitokondriale**


Ky lloj testimi identifikon variacionet gjenetike në ADN-në mitokondriale. Megjithëse shumica e ADN-së është e paketuar në kromosome brenda bërthamës së qelizës, strukturat qelizore të quajtura mitokondri gjithashtu kanë një sasi të vogël të ADN-së së tyre (e njohur si ADN mitokondriale). Si meshkujt ashtu edhe femrat kanë ADN mitokondriale, e cila transmetohet nga nënat e tyre, kështu që ky lloj testimi mund të përdoret nga secila gjini. Ai jep informacion rreth linjës së drejtpërdrejtë stërgjyshore femërore. Testimi i ADN-së mitokondriale mund të jetë i dobishëm për gjenealogjinë sepse ruan informacione rreth paraardhësve femra që mund të humbasin nga të dhënat historike për shkak të mënyrës se si mbiemrat shpesh transmetohen.

### **Testimi i polimorfizmit të një nukleotidi**

Këto teste vlerësojnë një numër të madh variacionesh (polimorfizma të vetme nukleotide ose SNP) në të gjithë gjenomin e një personi. Rezultatet krahasohen me ato të të tjerëve që i janë nënshtruar testeve për të dhënë një vlerësim të përkatësisë etnike të një personi. Për shembull, modeli i SNP-ve mund të tregojë se prejardhja e një personi është afërsisht 50 përqind afrikane, 25 përqind evropiane, 20 përqind aziatike dhe 5 përqind e panjohur. Gjenealogët përdorin këtë lloj testi sepse rezultatet e testit të kromozomit Y dhe ADN-së mitokondriale, të cilat përfaqësojnë vetëm linja të vetme stërgjyshore, nuk kapin sfondin e përgjithshëm etnik të një individi.

Testimi i prejardhjes gjenetike ka një sërë kufizimesh. Ofruesit e testeve krahasojnë rezultatet e testeve të individëve me bazat e të dhënave të ndryshme të testeve të mëparshme, kështu që vlerësimet e përkatësisë etnike mund të mos jenë të qëndrueshme nga një ofrues në tjetrin. Gjithashtu, për shkak se shumica e popullatave njerëzore kanë migruar shumë herë gjatë historisë së tyre dhe janë përzier me grupet e afërta, vlerësimet e përkatësisë etnike bazuar në testimin gjenetik mund të ndryshojnë nga pritshmëritë e një individi. Në grupet etnike me një gamë më të vogël variacionesh gjenetike për shkak të madhësisë dhe historisë së grupit, shumica e anëtarëve ndajnë shumë SNP dhe mund të jetë e vështirë të dallohen njerëzit që kanë një paraardhës të përbashkët relativisht të fundit, si kushërinjtë e katërt, nga grupi si e tërë.





Harta e e paraqitur tregon se si mund të duken kufijtë e Evropës, Lindjes së Mesme dhe Afrikës së Veriut nëse do të bazoheshin në haplogrupin dominues Y-ADN dhe jo në përkatësinë etnike dhe/ose në ndonjë konsideratë tjetër politike.

Këtu janë disa informacione shumë themelore për secilin grup:

**Haplogrupi R1b:** "Është prejardhja më e shpeshtë atërore në Evropën Perëndimore, si dhe në disa pjesë të Rusisë (p.sh. pakica Bashkir) dhe Afrikën Qendrore (p.sh. Çadi dhe Kameruni). Është gjithashtu i pranishëm në frekuenca më të ulëta në të gjithë Evropën Lindore, Azinë Perëndimore, si dhe në pjesë të Afrikës së Veriut dhe Azisë Qendrore. Haplogrupi R1a: "Shpërndahet në një rajon të madh në Euroazi, duke u shtrirë nga Skandinavia, Evropa Qendrore dhe Siberia Jugore deri në Azinë Jugore."

**Haplogrupi N:** "Ka një shpërndarje të gjerë gjeografike në të gjithë Euroazinë veriore, dhe gjithashtu është vërejtur herë pas here në zona të tjera, duke përfshirë Azinë Juglindore, Paqësorin, Azinë Jugperëndimore dhe Evropën Jugore."

**Haplogrupi I1:** "Haplogrupi arrin frekuencën e tij maksimale në Suedi (52 përqind e meshkujve në kontenë Västra Götaland) dhe Finlandën perëndimore (më shumë se 50 përqind në provincën Satakunta).[6] Për sa i përket mesatareve kombëtare, I-M253 gjendet në 35–38 përqind të meshkujve suedezë, 32,8% të meshkujve danezë, rreth 31,5% të meshkujve norvegjezë dhe rreth 28% të meshkujve finlandezë." Haplogrupi I2: "Haplogrupi arrin frekuencën e tij maksimale në Alpet Dinarike në Ballkan, ku burrat janë regjistruar si më të gjatët në botë, me një gjatësi mesatare mashkullore prej 185,6 cm (6 ft 1,1 in).

**Haplogrupi J1:** "Ky haplogrup gjendet sot në frekuenca të konsiderueshme në shumë zona në ose afër Lindjes së Mesme, dhe pjesë të Kaukazit, Sudanit dhe Etiopisë. Gjendet gjithashtu në frekuenca të larta në pjesë të Afrikës së Veriut, Evropës Jugore dhe midis grupeve hebreje, veçanërisht atyre me mbiemra Cohen. Mund të gjendet gjithashtu shumë më rrallë, por gjithsesi herë pas here në sasi të konsiderueshme, në të gjithë Evropën dhe deri në lindje deri në Azinë Qendrore dhe nënkontinentin Indian.

**Haplogrupi J2:** "Ai gjendet në Azinë Perëndimore, Azinë Qendrore, Azinë Jugore, Evropë dhe Afrikën e Veriut, por zakonisht lidhet me Azinë Veriperëndimore. Mendohet se J2 mund të ketë origjinën midis maleve të Kaukazit, Mesopotamisë dhe Levantit.

**Haplogrupi E:** "Shumica e anëtarëve të haplogrupit E-M96 i përkasin një prej nënkladave të tij të identifikuar dhe E-M96(xE-P147, E-M75) është i rrallë. E1a dhe E-M75 gjenden pothuajse ekskluzivisht në Afrikë. Duke parë frekuencat kryesore të nënkladës, mund të përcaktohen pesë rajone të gjera të Afrikës: Lindja, Qendrore, Veriu, Jugu dhe Perëndimi. Ndarja mund të dallohet nga prevalenca e E-V38 në Afrikën Lindore, Qendrore, Jugore dhe Perëndimore, E-M78 në Afrikën Lindore dhe E-M81 në Afrikën Veriore.

**Haplogrupi G:** "Në nivel të popullsisë kombëtare, G-M201 gjendet më së shpeshti në Gjeorgji; ai gjendet në nivele edhe më të larta në mesin e shumë popullsive të tjera rajonale dhe pakicë në Kaukaz. G-M201 është gjithashtu i shpërndarë gjerësisht në frekuenca të ulëta, midis grupeve etnike të Evropës, Azisë Jugore, Azisë Qendrore dhe Afrikës së Veriut.

Harta dhe të dhënat më lartë janë huazuar nga faqja: <https://brilliantmaps.com/europe-dna-borders/>

# *buletini* info

Kontriboni me shkrimet e juaja autentike si:

Opinione

Kulturë

Histori

Shkencë

Dërgoni në email: [buletini.info@gmail.com](mailto:buletini.info@gmail.com)